



Konkurs për Çmimin e BE-së për Gazetarinë Hulumtuese

Kosovë/2017

Udhëzime për dorëzim të aplikacioneve/nominimeve

Koordinatori nacional: Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës

Data e shpalljes së konkursit: 15 mars 2017

Data e fundit për aplikim: 5 prill 2017

Ky dokument është bërë me ndihmën financiare të Bashkimit Europian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Institutit të Paqes dhe Këshilli të Mediave të Shkruara të Kosovës, dhe në asnjë rrethanë nuk pasqyron pozitën e Bashkimit Europian.

Përmbajtja

1. Konteksti
2. Qëllimi
3. Fondi i çmimit
4. Rregullat e konkursit
 - 4.1 Cilat storie janë të kualifikueshme?
 - 4.2 Kush mund të aplikojë?
5. Si ta dorëzoni aplikacionin/nominimin?
 - 5.1 Aplikacioni
 - 5.2 Ku ta dorëzoni aplikacionin/nominimin?
 - 5.3 Data e fundit për aplikim
6. Informata të tjera
7. Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikacioneve
8. Njoftimi i kandidatëve/nominuesve lidhur me vlerësimin e jurisë

1. Konteksti

Projekti Çmimi i BE-së për gazetarinë hulumtuese në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi është themeluar nga Komisioni Europian, Drejtoria Gjenerale për Zgjerim duke ndjekur strategjinë për Zgjerim të BE-së, e cila parasheh nevojë të fuqishme për të siguruar lirinë e shprehjes në media, dhe për mbështetje të gazetarisë hulumtuese në monitorimin e proceseve reformuese, si dhe për ruajtjen e momentit historik drejt anëtarësimit në BE.

Çmimi për gazetarinë hulumtuese do të ndahet çdo vit në shtatë shtete të Zgjerimit të BE-së për tre vite me radhë: në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë*, Maqedoni, Mal të Zi, Serbi, dhe Turqi, për ta shpërblyer punën në gazetarinë hulumtuese të botuar në vitet 2014, 2015, 2016.

Për këtë çmim kualifikohen storiët hulumtuese të cilat kontribuojnë në transparencë si dhe raportojnë për çështje sociale në lidhje me keqpërdorimin e pushtetit dhe të të drejtave themelore, korrupsionin dhe krimin e organizuar në Kosovë, të cilat nuk do të ishin bërë të ditura për publikun në ndonjë mënyrë tjetër.

Fondi i çmimit për shtatë vendet përfituese për tri vite është 210,000 euro. Fondi i çmimit për çdo vit për secilin vend është 10,000 euro; 1-3 gazetarë do të shpërblehen në çdo vend, çdo vit; shpërblimi për secilin gazetar do të jetë ndërmjet 3000-5000 euro.

Çmimi menaxhohet nga partneriteti rajonal i organizatave të shoqërisë civile me koordinim të Institutit të Paqes në Ljubljane, i cili është përzgjedhur nga Komisioni Europian për këtë detyrë.

- Instituti Shqiptar i Medias (IShM), Tiranë, Shqipëri
- Media and Civil Society Foundation Mediacentar Sarajevo (MCF), Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë
- Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) Prishtinë, Kosovë
- Makedonski Institut za Mediumi (MIM), Shkup, Maqedoni
- Institut za Medije Crne Gore (IMCG), Podgoricë, Mal i Zi
- Novosadska Novinarska Škola (NNŠ), Novi Sad, Serbi
- Platform 24 (P24), Stamboll, Turqi
- Bashkëpunëtorë: Fondacioni The Guardian, Londër, Mbretëri e Bashkuar
- Bashkimi Europian do ta mbikëqyrë dhe aprovojë secilin hap të rëndësishëm të procedurave të çmimit.

2. Qëllimi

Çmimi i BE-së për gazetarinë hulumtuese ka për qëllim promovimin e të arriturave të larta të gazetarëve hulumtues si dhe përmirësimin e vizibilitetit të cilësisë së gazetarisë hulumtuese në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi. Ky çmim gjithashtu ka për qëllim promovimin e gjeneratës së re të gazetarëve hulumtues.

3. Fondi i çmimit

Fondi i çmimit në Kosovë për vitin 2017, (për të arriturat në vitin 2016), është **10,000 euro**.

Tri storiet më të mira do të shpërblehen me shuma ndërmjet 3000 dhe 5000 euro.

Konkursi përfshinë nënkategorinë për storien më të mirë hulumtuese nga gazetarët e rinj. Kjo storie gjithashtu kualifikohet për çmimin e përgjithshëm.

Çmimi individual është ndërmjet 3,000 dhe 5,000 euro. Çmimi për nënkategorinë për 'storien më të mirë hulumtuese nga gazetarët e rinj' është 3,000 euro.

Në raste të veçanta, juria mund të vendosë të mos i ndajë të gjitha çmimet nëse cilësia e storieve nuk është e duhur.

Shuma e çmimeve është në vlerën bruto nga e cila zbritja do të bëhet në përputhje me dispozitat vendore.

4. Rregullat e konkursit

4.1 Cilat storie janë të kualifikueshme?

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, si anëtar i partneritetit rajonal të organizatave të shoqërisë civile i cili e menaxhon Çmimin e BE-së për gazetarinë hulumtuese, shpall konkurs për çmimet për:

- Storiet hulumtuese të botuara në periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2016, të cilat raportojnë për çështje sociale në lidhje me keqpërdorimin e pushtetit dhe të të drejtave themelore, korrupsionin dhe krimin e organizuar në Kosovë, të cilat nuk do të ishin bërë të ditura për publikun në ndonjë mënyrë tjetër.

Për çmimin e BE-së mund të kandidohet për storiet hulumtuese të publikuara apo të transmetuara në çdo lloj të medias në Kosovë: në media të shkruara, radio, televizion, media online apo të kombinuara.

4.2 Kush mund të kandidojë?

Një gazetar apo grup gazetarësh mund të nominohen për Çmimin për storie hulumtuese të botuara/transmetuara nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2016, të cilat raportojnë për çështje sociale në lidhje me keqpërdorimin e pushtetit dhe të të drejtave themelore, korrupsionin dhe krimin e organizuar në Kosovë, të cilat nuk do të ishin bërë të ditura për publikun në ndonjë mënyrë tjetër.

Konkursi është hapur për gazetarët profesional të cilët janë të angazhuar në çfarëdo forme në media (psh. të punësuar me orar të plotë, punë me honorar/freelance, të vetëpunësuar, apo të ngjashme).

Ky dokument është bërë me ndihmën financiare të Bashkimit Europian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Institutit të Paqes dhe Këshilli të Mediave të Shkruara të Kosovës, dhe në asnjë rrethanë nuk pasqyron pozitën e Bashkimit Europian.

Gazetarët hulumtues të lindur në vitin 1981 apo më vonë apo një grup i gazetarëve me një gazetar udhëheqës dhe të paktën një gazetar në grup të lindur në vitin 1981 apo më vonë gjithashtu do të kualifikohet për nënkategorinë ‘storia më e mirë hulumtuese nga gazetarët e rinj’.

Për çmimin për gazetarinë hulumtuese mund të nominohen storiet hulumtuese të botuara apo të transmetuara në mediat e Kosovës (për qytetarët e Kosovës, në gjuhët zyrtare, gjuhët e minoriteteve apo ndërkombëtare).

Nominimet për storiet hulumtuese të botuara në mediat e Kosovës për publikun në Kosovë në gjuhët që nuk janë zyrtare në Kosovë duhet t’u bashkëngjitet edhe përkthimi në gjuhën zyrtare të vendit.

Aplikacionet/nominimet mund të dorëzohen nga:

- 1) Gazetarët/grupet e gazetarëve të cilët janë kandidatë për çmim (vetënomnimet)
- 2) Personat fizikë apo organizatat (p.sh. shoqatat e mediave, sindikatat, universitetet, etj) vetëm me pëlqimin paraprak të të nominuarëve.

Vetënomnimet janë veçanërisht të mirëseardhura.

Gazetarët apo grupet e gazetarëve mund të dorëzojnë **një apo më shumë aplikacione**. Secili aplikacion duhet të dorëzohet veçmas.

Kandidati për çmim dhe nominuesi pranojnë rregullat dhe kushtet e konkursit.

Kandidatët duhet të pranojnë se ata janë autorët e stories e cila nominohet dhe nëse zgjedhen fitues ata pranojnë të paraqiten në publik.

Kandidati/ja nuk mund të marrë pjesë në konkurs apo të jetë fitues i çmimit nëse ai/ajo është në pozitën që përshkruhet në paragrafin 2.3.3 të Doracakut të procedurave të jashtme të BE-së. Për më shumë informata, vizitoni:

<http://ec.europa.eu/europeaid/prag/document.do?nodeNumber=2.3.3>

5. Si të dorëzoni aplikacionin/nominimin?

5.1 Aplikacioni

Aplikacionet/nominimet duhet të plotësohen në pajtim me udhëzimet e dhëna. Formularët duhet të plotësohen në gjuhën zyrtare.

Aplikacionet/nominimet e plota përfshijnë:

1. Formularin A: Prezantimi i stories së nominuar dhe gazetarit

1.1 Shtojcën në Formularin A: Storia hulumtuese.

Në rast se historia hulumtuese është botuar apo transmetuar në ndonjë gjuhë tjetër nga gjuhët zyrtare, duhet të dorëzohet edhe përkthimi i saj në gjuhët zyrtare në formë të shkruar.

Ky dokument është bërë me ndihmën financiare të Bashkimit Europian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Institutit të Paqes dhe Këshilli të Mediave të Shkruara të Kosovës, dhe në asnjë rrethanë nuk pasqyron pozitën e Bashkimit Europian.

2. Formularin B: Deklarata e gazetarit dhe nominuesit

5.2 Ku të dorëzoni aplikacionin/nominimin?

Aplikacionet/nominimet duhet të dërgohen në mënyrë elektronike në **e-mail adresën:** euaward@presscouncil-ks.org me subjektin: Çmimi i BE-së Kosovë/2017 – emri i aplikuesit

Ju lutemi të ndiqni këto udhëzime për dorëzim:

- Formularët A dhe B duhet të dërgohen në formatin PDF. Nënshkrimet e kërkuara duhet të jenë të qarta.
- Storia hulumtuese bashkëngjitur tek formulari A duhet të dërgohet si në vijim:
 - a. *Tekstet e shtypit*: Bashkëngjitur të ketë storien në formatin PDF ose URL-në ku mund të lexohet historia.
 - b. TV/radio: URL-ja ku mund të shikohet/dëgjohet historia.
 - c. Online: URL-ja ku historia mund të jetë e qasshme.

Krahas dërgimit me e-mail, aplikacionet mund të dërgohen në një ekzemplar origjinal në zarf të mbyllur, me postë apo personalisht. Në atë rast, zarfi i mbyllur duhet të përmbajë formularin A dhe B të plotësuar si dhe shtojcën e Formularit A:

- a. *Tekstet e shtypit*: Bashkëngjitur të ketë storien në formatin PDF ose URL-në ku mund të lexohet historia.
- b. TV/radio: URL-ja ku mund të shikohet/dëgjohet historia.
- c. Online: URL-ja ku historia mund të jetë e qasshme.

Zarfi duhet të përmbajë emrin dhe adresën e personit/organizatës që dorëzon aplikacionin/nominimin si dhe shënimin “Çmimi i BE-së për gazetarinë hulumtuese”.

Adresa postare:

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës

Garibaldi, OB-1, HY-19, NR-12,

10000 Prishtinë, Kosovë

ose të vini personalisht nga e hëna deri të premten, nga ora 10:00 deri në ora 17:00

5.3 Data e fundit për dorëzim të aplikacioneve

Data e fundit për aplikim përmes e-mail-it : **5 prill 2017**

- Për aplikacionet e dërguara me postë: **5 prill 2017, 17:00**, zarfi duhet të ketë datën e dërgimit.
- Për aplikacionet e dorëzuara personalisht: **5 prill 2017, 17:00**, të protokolluar me nënshkrimin dhe datën e pranimit.

6. Informata të tjera

Të gjitha pyetjet mund t'i dërgoni në e-mail adresën: euaward@presscouncil-ks.org.

Përgjigjet në pyetjet e pranuar deri 5 ditë para përfundimit të afatit lidhur me dorëzimin e aplikacioneve/nominimeve do të ofrohen në web faqen: www.presscouncil-ks.org

7. Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikacioneve/nominimeve

Aplikacionet që janë në përputhje me kushtet administrative do të vlerësohen nga juria në kundërshtim me kriteret e çmimit:

Kriteret	Pikët MAX
1. Rëndësia e stories hulomtuese <ul style="list-style-type: none">– Sa janë të rëndësishme për shoqërinë në vend temat/rastet për keqpërdorim të pushtetit dhe të të drejtave themelore, korrupsionit dhe krimin të organizuar të shtjelluara nga historia hulomtuese?– Deri në çfarë mase historia zbulon fakte me rëndësi të madhe për interesin publik, të cilat më herët kanë qenë të mbajtura larg publikut nga figura të rëndësishme të pushtetit?	20
2. Cilësia e stories hulomtuese <ul style="list-style-type: none">– Sa e fuqishme është teza dhe a janë të elaboruara mirë çështjet kryesore?– Sa gjithpërfshirës/pëmbajtësor/i shkruar me kujdes e në detaje/ është bërë hulomtimi dhe është prezantuar historia? A përmban historia këndvështrime të ndryshme? Deri në çfarë mase janë vërtetuar të dhënat?– A është shkruar dhe hartuar mirë historia? A është i mirë stili i prezantimit?	40 10 15 15
3. Paanshmëria <ul style="list-style-type: none">– A janë të paraqitura mire faktet dhe a është e shkruar mire historia sa l përket standardeve etike dhe profesionale, veçanërisht korrektësisë dhe paanshmërisë?– A është shkruar historia në mënyrë të drejtë, ashtu që të mbulojë gjithë interesin në fjalë dhe të garantojë se nuk ekziston apo nuk promovohet asnjë interes l veçantë?– Me ç'fokus dhe koherencë u shpjegua konteksti i stories dhe u nxorën përfundimet, me konsideratë të duhur vetëm ndaj fakteve të verifikuara dhe	20

Ky dokument është bërë me ndihmën financiare të Bashkimit Europian. Përbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Institutit të Paqes dhe Këshilli të Mediave të Shkruara të Kosovës, dhe në asnjë rrethanë nuk pasqyron pozitën e Bashkimit Europian.

interesave relevante për temën?	
3. Originaliteti – Deri në çfarë mase stória hulumtuese trajtoi çështje të cilat më parë nuk janë bërë të ditura për publikun? – A ka sjellë autori ndonjë qasje të re me prezantimin e stories?	10
4. Integriteti profesional i gazetarit/-es – A ka shfaqur autori integritet profesional, veçanërisht për një periudhë afatgjate? – Sa është pasqyruar kjo në punën e tij/saj?	10
TOTAL	100

Kriteret shtesë në rast se dy apo më shumë aplikacione marrin pikë të njëjta:

Kriteri	Pikët max
5. Ndikimi – A është përcjellur stória nga mediumet tjera dhe a ka pasur ndonjë ndikim në opinionin publik? – A ka nxitur stória ndonjë veprim përcjellës nga ana e personave përgjegjës dhe/apo gjyqësorit?	10

Në rast të pranimit të një numri të madh të aplikacioneve, juria do të bëjë një përzgjedhje paraprake duke u bazuar në rëndësinë dhe cilësinë e aplikacioneve. Aplikacionet e përzgjedhura do të vlerësohen duke u bazuar në kriteret e lartpërmendura.

8. Njoftim për kandidatët/nominuesit për vendimin e jurisë

Aplikuesit/nominuesit do të njoftohen për rezultatet e konkursit përmes një letre njoftuese.